

VLERËSIM I MASAVE EKONOMIKE INSTITUCIONALE PËRBALLË REKOMANDIMEVE TË ECIKS

PRISHTINË, VJENË, CYRIH, MË 02 PRILL 2020

AUTORËT:

KUJTIM DOBRUNA, HAMËZ MORINA, DURIM HOXHA,
HANA TAHIRI, BARDHYL SALIHU



eciKS | Prishtina
Vienna
Zürich
Management Consulting

1. Hyrje

Menjëherë pasi qeveria e Kosovës ndërmori masat e para për të luftuar pandeminë e shkaktuar nga COVID-19a, të cilat kufizuan në masë të madhe veprimtaritë publike dhe ekonomike, ECIKS si e para organizatë në vend, duke parë rrezikun që i kanoset ekonomisë së vendit në përgjithësi e sektorit privat në veçanti, publikoi një [Dokument Pozicionues](#) drejtuar institucioneve ekonomike të vendit, me rekomandime për kundërmassat që duhen ndërmarrë për të lehtësuar gjendjen e sektorit privat. Këto masa u rekomanduan që të merren në linjë me konceptin „*me kohë, në cak dhe përkohësisht – timely, targeted, temporary*“. *Pra që të jenë të menjëhershme, të kenë për cak ndërmarrjet e prekura nga këto vendime dhe të jenë të përkohshme, për aq sa masat kufizuese të jenë në fuqi.*

ECIKS ka monitoruar gjendjen në vazhdimësi dhe po vlerëson masat mbështetëse që janë marrë deri më tani, ndërsa mund të shqyrtojë dhe propozojë masa shtesë.

Në faqet në vijim po paraqesim një përmbledhje të masave të rekomanduara nga ECIKS dhe reagimin e institucioneve ekonomike të vendit përballë këtyre propozimeve.

1. Vlerësim i masave ekonomike institucionale përballë rekomandimeve të ECIKS

Nr.	Rekomandimi	Masat e ndërmarra	Ndikimi
1.	Të krijohet një unitet politik pozitiv-opozitiv për të rritur besimin në legjitimitetin e institucioneve shtetërore dhe për të mundësuar zbatimin e lehtë të të gjitha masave.	Nuk është realizuar, uniteti është përkeqësuar.	Me rrëzimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës është shkaktuar një krizë e thellë politike, që e dëmton legjitimitetin institucional, shkakton frikë, paqartësi dhe pasiguri tek qytetarët dhe tek ndërmarrësit privat. Legjitimiteti institucional duhet të arrihet përmes performancës pozitive në të gjitha rrafshet e pushtetit: ekzekutiv, legjislativ dhe judikativ. Të gjitha këto institucione duhet të jenë të dukshme dhe unike në përballjen me krizën dhe në të gjitha çështjet praktike. Kur institucionet janë të përgjegjshme, qytetarët sigurohen se po bëhet maksimumi për të menaxhuar situatën dhe kjo krijon një ndjenjë stabiliteti e sigurie.
2.	Të parandalohet shndërrimi i kësaj situatë në një krizë sistemike ekonomike, që mund të ketë pasojë afatgjate për ekonominë në përgjithësi, ndërmarrësinë e papunësinë në veçanti.	Masat e ndërmarra nga qeveria në mbështetje të sektorit privat janë të mirëseardhura, por të pamjaftueshme, posaçërisht nëse kriza vazhdon edhe pas muajit prill 2020. Kufizimet buxhetore e fiskale e pamundësojnë një mbështetje më të fuqishme qeveritare për ndërmarrësit privat.	Efektet sistemike të shkaktuara si pasojë e kufizimit të lirisë së lëvizjes, rënies së ofertës dhe kërkesës, ndërprerjes së shërbimeve e prodhimit, mbetet të shihen në planin afatmesëm. Por, qysh tani mund të thuhet se ndikimi i kësaj krize në ekonominë e Kosovës do të jetë serioz dhe më i fuqishëm se ai i vitit 2008. Kriza do të prekë njëtrajtshëm sektorin publik dhe atë privat. Përderisa sektori publik do të përballlet me sfida buxhetore, fiskale e të papunësisë, sektori privat do të ketë sfida kryesore qasjen në treg, likuiditetin financiar dhe konkurrueshmërinë. Recesioni është i pashmangshëm, mbështetja eventuale financiare nga jashtë mund ta ndalojë rrëshqitjen drejt depresionit.

Nr.	Rekomandimi	Masat e ndërmarra	Ndikimi
3.	Të mbushet fondi rezervë me një shumë të konsiderueshme prej të paktën 50 milionë euro, për të siguruar likuiditetin e sektorit privat dhe për të lehtësuar qasjen në financa përmes zgjerimit të kompetencave dhe fushëveprimit të Fondit Kreditor të Kosovës.	Është identifikuar si problem por nuk është dhënë ndonjë premtim konkret. Fondi Kosovar për Garanci Kreditorë është diskutuar si mjet ndihmës, por pa ndonjë plan për zgjerimin e kompetencave dhe fushëveprimit të tij.	Mungesa e një fondi rezervë të dotuar mirë për nevoja të përballjes me krizën edhe gjatë muajve në vijim, shton pasigurinë financiare, nëse kriza do zgjasë edhe më shumë. Mospërfshirja e Fondit Kosovar për Garanci Kreditorë në masat e ndërmarra ia heq qeverisë një instrument të mirë nga dora, përmes së cilit duke dhënë garanci kreditorë, mund të ruaj stabilitetin buxhetor.
4.	Të mundësohet shtyrja e pagesës së obligimeve tatimore (TVSh-së, tatimit në fitim etj.) për të gjitha ndërmarrjet private nga sektorët e prekur për periudhën sa vlejné këto masa, pa aplikuar ndëshkime.	Ky propozim është realizuar plotësisht. Me vendimet e Qeverisë së Kosovës Nr. 01/07 dhe 01/09, si dhe vendimin e Ministrisë së Financave dhe Transfereve të datës 19.03.2020, është zgjatur afati për deklarimin, raportimin dhe pagesën e detyrimeve tatimore dhe kontributeve pensionale deri më 30.04.2020.	Më thellimin e pasojave të krizës, barra financiare e ndërmarrjeve sa shkon e rritet. Zvogëlimi i të hyrave në nivelin zero po e rrezikon mbijetesën e tyre. Shtyrja e pagesës së detyrimeve tatimore dhe kontributeve, do të përmirësojë likuiditetin afatshkurtër të ndërmarrjeve dhe kontribuojë në mirëmbajtjen e funksioneve vitale të ekonomisë së vendit.

Nr.	Rekomandimi	Masat e ndërmarra	Ndikimi
5.	Të lirohen ndërmarrjet në fjalë prej pagesës së tatimit në të ardhurat e të punësuarve për periudhën sa vlejné këto masa.	Ky propozim është realizuar pjesërisht. Sipas vendimeve të Qeverisë së Kosovës Nr. 01/07 dhe 01/09 është shtyrë deklarimi dhe pagesa e tatimit në të ardhurat e të punësuarve deri me 30 Prill 2020 mirëpo ndërmarrjet nuk janë liruar nga pagesat. Qeveria e Kosovës me vendimin Nr. 01/19 po ashtu ka vendosur të përkrahë ndërmarrjet e prekura nga kriza me mbulimin e shpenzimeve të pagave mujore në vlerë prej 170 Euro si dhe të kontributeve pensionale në këto paga.	Pakot mbështetëse të miratuara nga Qeveria e Kosovës do të kenë ndikim pozitiv në mbajtjen e nivelit të punësimit dhe aktivitetit afarist në përgjithësi. Subvencionimi i pjesëshëm i shpenzimeve të pagave mujore do të kontribuojë pozitivisht në likuiditetin dhe profitabilitetin e ndërmarrjeve, duke i motivuar ato të mos aplikojnë largime masive nga puna dhe duke ju lënë hapësirë që mjetet e disponueshme t'i shfrytëzojnë për sigurimin e mbarëvajtjes së afarizmit. Një lirim i plotë nga tatimi në të ardhurat e të punësuarve për kohën sa vlejné këto masa, do të lehtësonte edhe më shumë gjendjen e ndërmarrjeve private, përmirësonte likuiditetin dhe rriste gjasat për ruajtjen e vendeve të punës.
6.	Në bashkëpunim me sektorin bankar dhe Fondin Kreditor të Kosovës të mundësohet riprogramimi i borxheve dhe kredive rrjedhëse për të gjitha ndërmarrjet private nga sektorët e prekur për periudhën sa vlejné këto masa.	Ky propozim është realizuar pjesërisht. Banka Qendrore e Kosovës dhe Shoqata e Bankave të Kosovës kanë vendosur që ndërmarrjeve të prekura nga kriza të ju mundësohet pezullimi i pagesave për këstet e kredisë, nga data 16 mars 2020 deri me 30 prill 2020 dhe varësisht nga situata, ky pezullim të shqyrtohet edhe për më gjatë. Nuk është e njohur nëse janë përcaktuar kritere eksplicite për përfitim nga kjo masë. Pezullimi i pagesave për këstet e kredisë do të shqyrtohet nga bankat vendore për të gjitha rastet veç e veç.	Pezullimi i pagesave për këstet e kredisë për ndërmarrjet e prekura nga kriza do të kontribuoj në funksionimin më të lehtë të sektorit privat duke rritur aftësinë paguese të ndërmarrjeve, kontribuar në qarkullimin e brendshëm të mallrave dhe zvogëluar rrezikun e papunësisë. Një përfshirje e Fondit Kreditor të Kosovës do të lehtësonte barrën likuide për buxhetin e vendit, sepse përmes Fondit mund të lëshohen garanci kreditore shtesë, pa pasur nevojë të preken drejtpërsëdrejti linjat e buxhetit aktual të shtetit.

Nr.	Rekomandimi	Masat e ndërmarra	Ndikimi
7.	<p>Në bashkëpunim me ndërmarrjet prodhuese e tregtare të sigurohet një furnizim i qëndrueshëm me ushqime, medikamente dhe me lëndë të parë.</p>	<p>Problemet politike të ditëve të fundit kanë zhvendosur fokusin nga një dialog i nevojshëm publiko-privat për sigurimin e furnizimit të qëndrueshëm me mallra dhe produkte bazike.</p> <p>Fokusi ka qenë më tepër në masat që zbusin kufizimet në qarkullim. Janë dhënë leje specifike për transportuesit nga MPBAP, për t'ju mundësuar qarkullimin e tyre gjatë kohës së kufizimeve.</p> <p>Sidoqoftë, ka pasur një interesim të shtuar të akterëve relevant lidhur me sigurimin e furnizimit të qëndrueshëm me mallrat të domosdoshme.</p> <p>Nga ana tjetër sektori privat në këto rrethana është treguar më dinamik dhe ka gjetur kanale të furnizimit sidomos me miell, të pa ndikuara dhe të përkrahura nga shteti, duke siguruar furnizim të qëndrueshëm të qytetarëve.</p>	<p>Disa nga masat e ndërmarra kanë vështirësuar qarkullimin dhe transportin kombëtar dhe ndërkombëtar të mallrave.</p> <p>Rreziku i ndërprerjes së zinxhirëve ndërkombëtar të furnizimit kërkon aksione të menjëhershme e qasje të shpejtë dhe inovative. Në të kundërtën, vendi mund të mund të përballet me mungesë serioze të lëndës së parë dhe produkteve finale.</p> <p>Me anë tjetër, masat që zbusin kufizimet për grupe te caktuara, kanë ndikuar pozitivisht në lëvizjen e lirë të mallrave edhe në periudha kur është ndaluar qarkullimi.</p> <p>Në javët e ardhshme nuk pritet të ketë ndonjë krizë në furnizim. Probleme serioze mund të lindin nëse vështirësohet qarkullimi ndërkombëtar, i cili mund të rezultojë në ndërprerjen e kanaleve të furnizimit dhe importit, madje edhe të produkteve elementare.</p>

Nr.	Rekomandimi	Masat e ndërmarra	Ndikimi
8.	Të rritet sasia e rezervave shtetërore, produkteve bazë të konsumit, higjienës, medikamenteve, gazit, naftës dhe derivateve të saj.	Sipas të dhënave nga viti 2018 rezervat shtetërore mbulojnë nevojat e domosdoshme për 20 mijë banorë në kohëzgjatje prej 20 ditësh. MEPTINIS ka thënë se ka bërë planin e rezervave, të cilin ia ka paraqitur Ministrisë së Financave dhe Transfereve për përfshirje në buxhetin 2020. Për më tepër, MEPTINIS ka thënë se mallrat rezervë të ruajtura në depot e saj “janë të kompletuara për nga aspekti sasior dhe cilësor” dhe se “kryesisht rezerva ka për mallrat si: gruri, mallra agro-ushqimore, nafta dhe barna”. Për produktet tjera nuk është dhënë ndonjë njoftim.	Sasia e rezervave shtetërore konsiderohet tejet e vogël për nevojat e popullatës, ndërsa planifikimet buxhetore për rritjen e tyre vështirë se mund të garantojnë një mbulimin eventual të kërkesave emergjente. Për këtë arsye, rekomandimit nr. 7 duhet t’i kushtohet vëmendje e veçantë dhe sektorit privat t’i lihet hapësirë e mjaftueshme për tu kujdesur për sigurimin e mjaftueshëm të furnizimit në treg. Edhe masat mbështetëse për bujqit vendor do të kenë efekt pozitiv në sigurimin e furnizimit, me kusht që këto masa përfshijnë edhe mbështetje për bujqit për të lehtësuar qasjen në tregun vendor.

Nr.	Rekomandimi	Masat e ndërmarra	Ndikimi
9.	<p>Të ruhet stabiliteti i çmimeve, duke luftuar rritjet artificiale e ilegale të tyre. Por, nëse rritjet e çmimeve janë të paevitueshme si rrjedhojë e ndryshimeve të theksuara të ofertës dhe kërkesës në tregun ndërkombëtar apo vendor, atëherë rritjet e këtilla që janë të paevitueshme duhet lejuar në mënyrë që të mos vije deri tek mungesa e mallrave në treg.</p>	<p>Kjo masë është marrë parasysh nga qeveria e Kosovës. Me disa përjashtime, stabiliteti i çmimeve është ruajtur në përgjithësi, posaçërisht pas vendimit për të sanksionuar rritjet ilegale të çmimeve. Megjithatë, rritja drastike e kërkesës për disa produkte si mielli ka sjellë rritje reale të çmimeve, pengesa e së cilës rritje ka shkaktuar mungesë të mallrave dhe radhë të gjata të pritjes. Si pjesë e këtyre masave, MEPTINIS është zotuar që të heq barrierat për importuesit e miellit dhe grurit, për të siguruar furnizim të mjaftueshëm dhe mbajtje të stabilitetit të çmimit. Po ashtu, Këshilli për Bashkëpunim Rajonal ka mundësuar krijimin e korridoreve të gjelbra që mundësojnë qarkullimin e lirë të mallrave të domosdoshme, duke përfshirë grurin dhe miellin, në mënyrë që të ketë furnizim të mjaftueshëm dhe të mos vije deri tek ngritja e çmimeve si pasojë e kërkesës së madhe.</p>	<p>Pavarësisht masave të ndërmarra nga qeveria për gjobitje të bizneseve që kanë bërë ngritje ilegale të çmimeve si dhe masave për mbështetje ndaj importuesve të produkteve bazë, duhet të vazhdohet me përpjekjet për ruajtjen e stabilitetit të çmimeve për produktet esenciale.</p> <p>Hapat e MEPTINIS për të lehtësuar një furnizim të rregullt të tregut, duhet të koordinohen me përpjekjet e ndërmarrësve privat për të siguruar stoqe të mjaftueshme të produkteve në treg. Kështu mund të mënjanohet paniku dhe blerjet me shumicë nga konsumatorët privat, të cilat mund të shpijnë deri tek ngritja e menjëhershme e çmimeve.</p>

Nr.	Rekomandimi	Masat e ndërmarra	Ndikimi
10	<p>Sektori financiar i Kosovës konsiderohet si mjaft stabil. Megjithatë, në rast se vije deri te një krizë e besimit në institucionet financiare, atëherë qeveria e Kosovës dhe Banka Qendrore e Kosovës, në bashkëpunim me Bankën Qendrore Evropiane, duhet të kujdesën për sigurimin e likuiditetit të plotë të ekonomisë së vendit.</p>	<p>Nuk është marrë ndonjë masë apo hartuar ndonjë strategji se si do të veprohet në rast të rritjes së fluksit të qytetarëve për tërheqje të depozitave. Kryeministri i Kosovës, pas takimit me udhëheqësit e bankave komerciale, ka deklaruar se, “sistemi bankar i Kosovës ka likuiditet të mjaftueshëm dhe depozitat e qytetarëve janë të sigurta. Nuk ka pasur, nuk ka dhe nuk pritet të ketë asnjë kufizim në disponibilitetin e parasë së gatshme në ekonomi.” Megjithatë, asnjë masë nuk është marrë ose bërë e ditur për një plan B në rast se tundet besimi në institucionet financiare, qytetarët fillojnë të tërheqin masoisht depozitat bankare, apo valuta euro përjeton një krizë të pariparueshme.</p>	<p>Përderisa ende nuk ka ndonjë plan konkret ose masë të propozuar për të siguruar stabilitet të mëtutjeshëm sa i përket sistemit financiar, deklaratat nga BQK janë se “sektori bankar është mirë i kapitalizuar dhe shumë likuid, si dhe në të njëjtën kohë është duke funksionuar normalisht dhe do të vazhdojë të funksionojë sado që të zgjasë emergjenca shëndetësore”. Megjithatë, pavarësisht garancisë së BQK për likuiditet të mjaftueshëm, mos hartimi i një plani B paraqet një rrezik në rast se situata aktuale vazhdon edhe më gjatë, sepse ndërmarrjet si pasojë e ndaljes së ciklit ekonomik bëhen jolikuide apo falimentojnë krejtësisht, ndërsa qytetarët nuk mund të kthejnë kreditë si pasojë e papunësisë eventuale të shkaktuar. Në një skenar të tillë pa ndonjë strategji konkrete, pasojat për të ardhmen e afërt do të ishin tejet të rënda për ekonominë.</p> <p>Përpos kësaj, institucionet e vendit duhet të hartojnë një plan emergjent për aplikimin e një valute të re, në rast se valuta euro përjeton një krizë të pariparueshme, e cila mund të çojë në shpërbërjen e eurozonës.</p>